



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 992/2 prot.,

Datë 25.04.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ONI” SHPK & “CARA” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muajor” me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Lënien të skualifikuar të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës “CLIMACASA” SHPK, SULOLLARI-KLIMA” SHPK, “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK, në procedurën e sipërcituar.

Ankimues:

BOE “ONI” SHPK me NIPT J66902008N dhe adresë Lagjia Vasil Shanto, Rruga Hydajet Lezha, Nr.32, Shkodër & “CARA” SHPK me NIPT K07729920F dhe adresë Dibër, Burrel, Lagjia Pjeter Budi, Rruga Abdi Mati, Ndërtesë private Nr.10.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë Shqiperi Lezhe,

Lagjja Beselidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati perdhe, Njesia me numer pronesia 5/82-N1, ZK Nr. 863.

Operatori ekonomik "SULLOLLARI-KLIMA" SHPK me NIPT K01529003M dhe adresë Tirane Tirane, TIRANE, Rruga "Muhamet Gjollësia 71/3, Kati 1.

Operatori ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION" SHPK me NIPT K71401004Ë dhe adresë Tirane Tirane, , Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë me adresë Rruga "5 Maji", Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2024/4004, datë 24.04.2024 dhe me Nr.992/2024 Prot., datë 24.04.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë "ONI" SHPK & "CARA" SHPK, për procedurën e prokurimit "*E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor*" me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: "*Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike*", me fond limit 24 106 880 (*njzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë*) Lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ONI" SHPK & "CARA" SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi lënien të skualifikuar të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës "CLIMACASA" SHPK, SULLOLLARI-KLIMA" SHPK, "KEVIN KONSTRUKSION" SHPK, në procedurën e sipërcituar, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim sipas refuzimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat "b" dhe "c" të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", ku parashikohet se: "*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti*

kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ONI” SHPK & “CARA” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- “1. Bashkimi i operatoreve ekonomike Oni sh.p.k & Cara sh.p.k, nuk ploteson kerkesat e pikes 4.4 te Dokumentave Standarte te Tenderit, tek Kriteret e perzgjedhjes se fituesit Seksioni 4 Procedura, pasi oferta ekonomike nuk eshte paraqitur si shumatore e çmimeve per njesi.*
- 2. Operatori ekonomik Oni sh.p.k pjesemarrës ne BOE, nuk ploteson kerkesat e pikes 2.1.2 te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit pasi Çertifikata ISO 9001: 2015 e paraqitur nuk perfshin objektin e prokurimit.*
- 3. Operatori ekonomik Oni sh.p.k pjesemarrës ne BOE, nuk ploteson kerkesat e pikes 2.1.2 te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit pasi Çertifikata ISO14001 : 2015 e paraqitur nuk perfshin objektin e prokurimit.*
- 4. Bashkimi i operatoreve ekonomike Oni sh.p.k & Cara sh.p.k, nuk plotesojne piken 2.1.2 te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, pasi nuk kane paraqitur asnje dokumentacion ne lidhje me njohjen e entit certifikues, nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit.*
- 5. Ndarja ne perqindje e bashkimit te operatoreve ekonomike Oni sh.p.k & Cara sh.p.k, rezuton se ka paqartesi pasi eshte paraqitur ndarja ne perqindje sipas zerave te sherbimit por jo ne vlere.”.*

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ONI” SHPK & “CARA” SHPK që të mbeten të skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës “CLIMACASA” SHPK, “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim sipas refuzimit të bërë nga autoriteti kontraktor.

Konkretisht: Autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me arsyetimin si më poshtë vijon:

-Për operatorin ekonomik “CLIMACASA” SHPK: *“Operatori ekonomik ofertues Climacasa sh.p.k, nuk ploteson piken 1 a), te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit pasi ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit (Shtojca 9), eshte deklaruar numri i punonjesve por nuk jane deklaruar gjeneralitet per secilin nga punonjesit e kerkuar”.*

-Për operatorin ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK: *“1. Nuk ploteson piken 2.1.2 te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne lidhje me akreditimin e entit certifikues qe ka leshuar certifikatat ISO 9001 dhe 14001 te paraqitura ne SPE. 2. Nuk ploteson piken 1 a), te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit pasi ne Formularin*

permbledhes te vetdeklarimit (Shtojca 9), eshte deklaruar numri i punonjesve por nuk jane deklaruar gjeneralitet per secilin nga punonjesit e kerkuar.”

-Për operatorin ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK: “1. Operatori ekonomik AED sh.p.k pjesemarres ne BOE, nuk ploteson kerkesat e pikes 2.2.1 te Krieteve te Veçanta te Kualifikimit pasi pasqyrat finaciare vjetore te paraqitura per vitet 2020, 2021, 2022 jane te paçertifikuara nga organet tatimore. 2. Operatori ekonomik AED sh.p.k pjesemarres ne BOE, nuk ploteson kerkesat e pikes 2.1.2 te Krieteve te Veçanta te Kualifikimit pasi çertifikata ISO 14001:2015 nuk eshte paraqitur. 3. Operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k pjesemarres ne BOE, nuk ploteson kerkesat e pikes 2.1.2 te Krieteve te Veçanta te Kualifikimit pasi Çertifikatat ISO 9001 dhe 14001 te paraqitura nuk perfshijne objektin e prokurimit sipas zerave te sherbimeve te marra persiper ne marreveshjen e bashkepunimit. 4. Operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k pjesemarres ne BOE, nuk ploteson kerkesat e pikes 2.3.1 te Krieteve te Veçanta te Kualifikimit pasi kontratat e sherbimeve te ngjashme te paraqitura nuk perputhen me objektin e prokurimit. 5. Bashkimi i operatoreve ekonomike AED sh.p.k & Kevin Konstruksion sh.p.k, nuk plotesojne kerkesat e pikes 4.4 te DST Kriteret e perzgjedhjes se fituesit Seksioni 4 Procedura, pasi oferta ekonomike nuk eshte paraqitur si shumatore e çmimeve per njesi. 6. Bashkimi i operatoreve ekonomike AED sh.p.k & Kevin Konstruksion sh.p.k, nuk ka plotesuar Shtojcen Nr.2 Lista e çmimeve te sherbimeve, per asnje nga zerat e sherbimeve te kerkuara ne dokumentat standarte te tenderit.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 25.04.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri